

## **Oda e Farmacistëve të Kosovës**

Letër Menaxhmenti  
për vitin 2021, 2020 dhe 2019

Për menaxhmentin e ODA E FARMACISTËVE TË KOSOVËS  
Prishtinë, Kosovë

Shtator 2022

Të nderuar,

**Letër Menaxhmenti për vitin e mbaruar me 31 Dhjetor, 2021, 2020 dhe 2019**

Gjatë planifikimit dhe kryerjes së auditimit të pasqyrave financiare të Oda e Farmacistëve të Kosovës për vitin e mbaruar më 31 Dhjetor 2021, 2020 dhe 2019 kemi konsideruar strukturën e brendshme në mënyrë që të vendosim për procedurën e auditimit dhe përgatitjen e pasqyrave financiare të audituara, por jo për të ofruar siguri në kontrollin e brendshëm.

Ne kemi kontrolluar në bazë të mostrimit, prova që mbështesin shumat dhe pohimet në pasqyrat financiare. Për më tepër, kemi vlerësuar parimet e kontabilitetit të përdorura nga menaxhmenti.

Qëllimi i kësaj letre të menaxhmentit është që ti prezentoj një sërë rekomandimesh menaxhmentit të organizatës duke u bazuar në gjetjet e auditorit përgjatë rrjedhës së auditimit. Synimi i letrës së menaxhmentit nuk është të kritikoj ose dënoj aktivitetet të cilat janë vërejtur. Mirëpo, synimi është që të propozojë përmirësime në fushat ku auditori mendon se duhet të ketë ndonjë të tillë.

Çështjet e ngritura në këtë letër janë vetëm ato që kanë kapur vëmendjen tonë gjatë rrjedhës së auditimit dhe jo domosdoshmërisht deklarata të plota e të gjitha përmirësimeve që mund të bëhen.

Do të ishte kënaqësi të diskutojmë për çështjet e ngritura gjatë auditimit dhe të asistojmë menaxhmentin për të implementuar ato nëse është e nevojshme.

Po ashtu duam që të shprehim falenderimin tonë për bashkëpunimin e menaxhmentit dhe punonjësve të organizatës Oda e Farmacistëve të Kosovës gjatë punës sonë.

Në rast se keni ndonjë pyetje mos hezitoni të na kontaktoni.

Sinqerisht,

ACA - Audit & Consulting Associates  
Prishtina, Kosovë



# Oda e Farmacistëve të Kosovës

## Letër Menaxhmenti

---

### PËRGJEGJËSITË E MANAXHMENTIT PËR KONTROLL TË BRENDSHËM

#### **Përgjegjësitë e Menaxhmentit**

Menaxhmenti është përgjegjës për të themeluar dhe për të mbajtur kontrollin e brendshëm. Në përmbushjen e kësaj përgjegjësie, vlerësimet dhe gjykimet e menaxhmentit kërkohen që të vlerësojnë përfitimet e menduara dhe kostot e lidhura të kontrollit.

#### **Objektivat**

Objektivat e kontrollit të brendshëm shërbejnë për ti dhënë menaxhmentit një siguri të arsyeshme por jo absolute që asestet janë të mbrojtura nga humbja e përdorimit të paautorizuar dhe se transaksionet janë të ekzekutuara në përputhje me autorizimin e menaxhmentit dhe janë të regjistruara në mënyrë të duhur që lejojnë pregaditjen e pasqyrave financiare dhe janë në përputhje me Standardet Kosovare të Kontabilitetit.

#### **Kufizimet**

Për shkak të kufizimeve të cilat janë ekzistuese në çdo kontroll të brendshëm, mund të ndodhin deklarata të gabuara të cilat nuk mund të vërehen për shkak të gabimeve ose mashtrimeve. Poashtu, parashikimet e çdo vlerësimi të kontrollit të brendshëm për periudhat e së ardhmes janë të hapura ndaj rreziqeve sepse kontrolli i brendshëm mund të jetë jo-adekuat për shkak të ndryshimeve të kushteve ose rënjes së nivelit të pajtueshmërisë me politikatat dhe procedurat.

**PËRMBLEDHJE**

<b>1. FORMIMI DHE FUNKSIONALIZIMI I ORGANEVE MBIKQYRËSE .....</b>	<b>1</b>
<b>2. RESPEKTIMI I VENDIMEVE TË ORGANEVE MBIKQYRËSE.....</b>	<b>3</b>
<b>3. DOSJET E LICENCIMIT .....</b>	<b>4</b>
<b>4. DOSJET E ANTARËSISË.....</b>	<b>5</b>
<b>5. DIFERENCA NË MES TË LISTAVE TË TË LICENCUARËVE .....</b>	<b>6</b>
<b>6. AKREDITIMET E KOMISIONIT PËR EVP .....</b>	<b>7</b>
<b>7. ÇËSHTJET LIDHUR ME PAGAT .....</b>	<b>8</b>
<b>8. DIFERENCA NË MES TË LISTAVE TË PAGAVE.....</b>	<b>9</b>

### 1. FORMIMI DHE FUNKSIONALIZIMI I ORGANEVE MBIKQYRËSE

#### **Gjetjet**

Gjatë procesit të auditimit ne kemi kontrolluar edhe funksionimin e organeve mbikqyrëse të Odës në bazë të ligjit “Për Odat e Profesionisteve Shëndetësor”. Në bazë të statutit të vitit 2015 Oda duhet të ketë të formuara këto organe:

- Kuvendi;
- Kryetari i Odës;
- Këshilli drejtues;
- Këshilli mbikëqyrës i Odës;
- Këshilli etik;
- Gjyqi i nderit;
- Prokurori i Odës;
- Komisionet e përhershme të Odës.

Komisionet e përhershme të odës:

- Komisioni për çështje etike;
- Komisioni për licencim;
- Komisioni për edukim specialistik;
- Komisioni për edukim të vazhdueshëm profesional;
- Komisioni për praktikën profesionale;
- Komisioni për buxhet dhe financa;
- Komisioni i solidaritetit dhe ndihmës reciproke.

Me datën 11.09.2015 kuvendi mori vendim për formimin e këtyre organeve dhe komisioneve të përhershme:

- Këshilli mbikëqyrës i Odës;
- Këshilli etik;
- Komisioni për licencim;
- Komisioni për edukim të vazhdueshëm profesional;
- Komisioni për praktikën profesionale;
- Komisioni për buxhet dhe financa;
- Komisioni i solidaritetit dhe ndihmës reciproke.

Më 09.07.2018 është mbajtur mbledhja e kuvendit ku janë marrë vendime për formimin e komisioneve tjera por ato ende nuk janë të plota.

Për më tepër kemi vërejtur se komisioni për mbikqyrjen e financave të Odës nuk është mbledhur dhe nuk ka ushtruar funksionin e vet.

Poashtu gjatë procesit të auditimit kemi vërejtur se një numër i madh i dokumenteve të brendshme janë pa datë dhe të panënshkruara, si për shembull:

- Rregullorja e Komisionit për edukim të vazhdueshëm profesional
- Rregullorja për Ndihmë Reciproke dhe Solidaritet

## **Oda e Farmacistëve të Kosovës**

### **Letër Menaxhmenti**

---

- Rregullorja për funksionimin e Komisionit për Licencim
- Rregullorja mbi punën e këshillit mbikqyrës të odës farmaceutike të Kosovës etj.

Poashtu, kemi vërejtur se dokumentet në bazë të së cilave janë formuar komisionet në vitin 2015 në fund të faqes kanë të shkruar 'Prishtinë 2017'.

### **Rreziqet**

Mosformimi ose mosfunksionalizimi i organeve të parapara me ligjin për odat, ndikon në një udhëheqje, mbikqyrje dhe funksionim të dobët të odës. Gjithashtu vendimet e marra nga Kuvendi i Odës, e të cilat janë të panëshkruara dhe pa datë mund të ndikojnë keq në funksionimin e odës duke mos ditur datën prej kur ka hy në fuqi një vendim i caktuar.

### **Rekomandimet**

Në mënyrë që të ketë një funksionim, mbikqyrje dhe udhëheqje më të mirë të Odës, rekomandojmë që të formohen të gjitha organet odës të parapara me ligj dhe të bëhet funksionalizimi i mirëfilltë i tyre. Gjithashtu rekomandojmë që të shqyrtohen të gjitha vendimet e marra në takimet e Kuvendit të Odës dhe të gjitha ato të jenë dokumente të nënshkruara dhe zyrtare.

### **Përgjigja e menaxhmentit**

### **Statusi në auditimin e viteve 2021, 2020 dhe 2019**

E zgjidhur.

## **2. RESPEKTIMI I VENDIMEVE TË ORGANEVE MBIKQYRËSE**

### ***Gjetjet***

Gjatë procesit të auditimit kemi vërejtur se janë disa vendime të organeve mbikqyrëse të cilat nuk respektohen në përpikëri. Njëri prej tyre është vendimi për pagesën e antarësisë që është marrë më 31.08.2018 nga Këshilli Drejtues e që ka të bëjë me pagesat e antarësisë. Në vendim thuhet 'pagesat e antarësisë' për vitin duhet të realizohen deri më 31 dhjetor të vitit përkatës, në të kundërtën do të aplikohen masa disiplinore konform nenit 25 të ligjit për Odat e Profesionistëve Shëndetsor.

Gjatë procesit të auditimit, kemi vërejtur se nuk janë aplikuar asnjëherë masa të tilla.

### **Rreziqet**

Moszbatimi i vendimeve të organeve mbikqyrëse mund të paraqes rrezik për mbarëvajtjen e punëve të Odës dhe në rastin konkret mund të shkaktoj edhe pasoja në likuiditetin financiar të Odës për shkak të mosmbledhjes së detyrime të antarëve të saj.

### **Rekomandimet**

Rekomandojmë që vendimet e organeve mbikqyrëse të respektohen në përpikëri. Gjithashtu, rekomandojmë që Këshilli Drejtues të aplikoj monitorime të vazhdueshme që të përcjellë zbatueshmërinë e vendimeve të saj.

### **Përgjigja e menaxhmentit**

#### **Statusi në auditimin e viteve 2021, 2020 dhe 2019**

E zgjidhur.

### 3. DOSJET E LICENCIMIT

#### **Gjetjet**

Gjatë procesit të auditimit është vërejtur se dosjet e licencimit nuk janë të plota dhe ka mungesë të dokumentacionit përcjellës të kërkuar sipas Nenit 5 të Udhëzimit Administrativ Nr. 10/2011 dhe "Formularit për dokumentacionin e nevojshëm për licencim".

Nga mostra e kontrolluar prej 27 rasteve, në një rast kemi vërejtur se mungon pagesa në bankë. Në 4 prej tyre kemi vërejtur se mungon dëshmia e pagesës për antarësi. Në 11 prej tyre kemi vërejtur se mungon dëshmia e anëtarësisë. Kemi hasur edhe raste tjera ku mungon ID, foto etj.

#### **Rreziqet**

Mosplotësimi i të gjitha kriterëve për licencim, përfshirë edhe pagesat për antarësi nga ana e të licencuarve ndikon në dosje të mangëta dhe moszbatim i kërkesave të përcaktuara me ligj. Lëshimi i licencave duke mos u paguar antarësia, ndikon drejtpërdrejt në trajtim jo të barabartë të të gjithë antarëve të odës si dhe në të hyra më të ulëta e si rrjedhojë edhe nën-deklarim ose mbideklarim të të hyrave nga Licencim/Rilicencimi dhe Antarësia.

#### **Rekomandimet**

Rekomandojmë që të bëhet kompletimi i të gjitha dosjeve egzistuese si dhe për të gjitha licencat e lëshuara në të ardhmen të bëhet kompletimi i dosjes së secilit person të licencuar.

#### **Përgjigja e menaxhmentit**

#### **Statusi në auditimin e viteve 2021, 2020 dhe 2019**

E zgjidhur.



#### 4. DOSJET E ANTARËSISË

##### **Gjetjet**

Gjatë procesit të auditimit është vërejtur se dosjet e anëtarësisë nuk janë të plota dhe ka mungesë të dokumentacionit përcjellës.

Ne kemi kontrolluar një mostrë prej 116 rasteve. Në disa raste kemi vërejtur se mungon çertifikata e nënshtetësisë, në dy raste kemi vërejtur se kopja e licencës nuk është e noterizuar. Për më tepër kemi vërejtur mospërputhje në mes të listës së anëtarëve dhe pagesave të pranuar në bankë, ku për 12 raste nuk kemi gjetur dëshmi të pagesës në bankë për vitin 2018.

##### **Rreziqet**

Dukuria e mospërputhjes në mes listës së anëtarëve dhe pagesave të pranuar në bankë, jep një paraqitje jo të drejtë dhe jo të saktë të informatave të mbajtura nga administrata e odës e cila mund të rezultoj në deklaram jo të saktë të të hyrave nga antarësia.

##### **Rekomandimet**

Rekomandojmë që të kontrollohet edhe një herë lista e anëtarëve të odës dhe të dihen saktë obligimet e secilit anëtar dhe nëse ka obligime të pashlyera nga ta, të informohen dhe të bëhet pagesa për antarësinë e pashyer.

##### **Përgjigja e menaxhmentit**

##### **Statusi në auditimin e viteve 2021, 2020 dhe 2019**

E zgjidhur.

## 5. DIFERENCA NË MES TË LISTAVE TË TË LICENCUARËVE

### **Gjetjet**

Gjatë procesit të auditimit ne kemi marrë një listë të të licencuarëve nga zyrtarët e Odës. Të njëjtën e kemi krahasuar me listën e publikuar në webfaqen e Odës. Kemi vërejtur se një anëtar që figuron në listën e marrë nga webfaqja mungon në listën që e kemi pranuar dhe një rast tjetër ka ndodh anasjelltas. Për më tepër, kemi vërejtur se lista interne ka më shumë antarë (19) të licencuar sesa lista e publikuar.

### **Rreziqet**

Mospërputhja në mes të listës interne të Odës dhe listës së publikuar në web faqen e odës jep një paraqitje jo të drejtë të informatave ndaj palëve të treta. Për më tepër kjo mund të shkaktoj edhe paknaqësi te antarët e licencuar të cilëve nuk ju ka publikuar emri në webfaqen e odës që edhe mund të rezultoj në ndonjë padi eventuale dhe humbje financiare për odën.

### **Rekomandimet**

Rekomandojmë që lista e të licencuarve e publikuar në web faqen e odës të përditësohet në baza më të shpeshta kohore dhe të jetë në përputhshmëri të plotë me listën interne.

### **Përgjigja e menaxhmentit**

### **Statusi në auditimin e viteve 2021, 2020 dhe 2019**

E zgjidhur.

## **6. AKREDITIMET E KOMISIONIT PËR EVP**

### ***Gjetjet***

Gjatë vitit 2017 akreditimet e kompanive/organizatave që kanë aplikuar për organizimin e aktiviteteve për edukim të vazhdueshëm profesional janë bërë përmes email-it. Në vitin 2018 këto janë aprovuar me vendime të komisionit për EVP.

Për më tepër në bazë të rregullores për EVP, aktivitetet e organizuara duhet të publikohen në webfaqen e Odës dhe pas përfundimit organizatori duhet të përgatis një raport lidhur me mbarëvajtjen e aktiviteteve të EVP-së. As publikimi në webfaqe dhe raporti nuk janë bërë nga organizatorët.

### **Rreziqet**

Mospublikimi i aktiviteteve të Odës që lidhen me EVP mund të rezultoj në mungesë të informatave për antarët e Odës në lidhje me aktivitetet e parapara për EVP që potencialisht mund të ketë edhe efekt financiar për shkak të humbjes së aktiviteteve që janë pjesë relevante për licencim.

### **Rekomandimet**

Rekomandojmë që për të gjitha akreditimet e kompanive/organizatave për organizimet e aktiviteteve për edukim të vazhdueshëm profesional të zbatohen në përpikmëri të gjithë hapat që duhet të ndërmerren sipas Rregullores së Komisionit për edukim të vazhdueshëm profesional duke përfshirë edhe publikimin në webfaqen e Odës për aktivitetet e planifikuara dhe të realizuara.

### **Përgjigja e menaxhmentit**

#### **Statusi në auditimin e viteve 2021, 2020 dhe 2019**

E zgjidhur.

## 7. ÇËSH TJET LIDHUR ME PAGAT

### **Gjetjet**

Gjatë procesit të auditimit të pagave kemi vërejtur se disa anëtarë të komisioneve janë paguar në bazë të një liste të nënshkruar nga pjesëmarrësit por nuk kemi gjetur ndonjë dëshmi apo procesverbal të mbledhjeve të mbajtura.

Për më tepër, pagesat për kompenzim janë bërë në bruto e jo në neto sipas rregullores. Një konfuzion është shkaktuar sepse janë dy vendime të të njejtës datë por me përshkrim të ndryshëm përsa i përket kalkulimit të pagës për anëtarët e komisionit. Më datën 30.03.2017 Kuvendi ka lëshuar dy vendime që janë në kundërtënie me njëra-tjetrën, më saktësisht pika 6 e këtij vendimi. Kjo ka shkaktuar edhe implikime financiare pasi që njëra kopje l'u është vënë në dispozicion kontabilistit për kalkulimin e pagave. Në Shtator të vitit 2019 është marrë vendimi që kompenzimi të bëhet retroaktivisht në bazë të paragrafit ku saktëson se meditet prej 25€ neto dhe në bazë të këtij vendimi është bërë korigjimi për komenzimet e vitit 2018 për anëtar të komisioneve.

Edhe pse vendimi është marrë në vitin 2017, më saktësisht pika e 11/15 (varësisht se cilit dokument i referohemi) thotë që ky vendim duhet të zbatohet retroaktivisht. Në bazë të këtij vendimi punohet edhe sot për korigjimin retroaktiv të lëshimeve në kompenzimin e antarëve të komisioneve.

Poashtu kemi vërejtur se stafi permanent në administratën e Odës nuk kanë kontrata valide të punës.

### **Rreziqet**

Dëshmitë e dobëta për pagesa retroaktive për anëtarët e komisioneve të ndryshme mund të ndikojë që oda të ketë shpenzime të mbivlerësuara të pagave.

Gjithashtu mosdefinimi i vendimeve të të njejtës datë por me kuptime të ndryshme mund të ndikojë në deklarime jo të drejta të pagave por edhe obligime apo pagesa të tepërta të odës ndaj anëtarëve të saj.

Mungesa e kontratave të punës mund të rezultoj në gjoba nga autoritet dhe të ketë implikime financiare.

### **Rekomandimet**

Rekomandojmë që për pagesat retroaktive të ketë një mbikqyrje më të madhe dhe dëshmi më të mira gjatë kërkesës për pagesë e gjithashtu edhe të ketë një kufizim kohorë për përfundimin e këtyre pagesave. Gjithashtu rekomandojmë që të përcaktohet se cili nga vendimet e kuvendit për pagesë të antarëve është i saktë, të bëhen të gjitha korigjimet e nevojshme të pagave dhe të vazhdohet me deklaram të drejtë të tyre.

Gjithashtu rekomandojmë që në afat sa më të shkurt të lidhen kontratat në mes të odës dhe personelit.

### **Përgjigja e menaxhmentit**

#### **Statusi në auditimin e viteve 2021, 2020 dhe 2019**

E zgjidhur.

## **8. DIFERENCA NË MES TË LISTAVE TË PAGAVE**

### ***Gjetjet***

Gjatë procesit të auditimi kemi vërejtur se ka diferenca në mes të listave të pagave që kemi pranuar nga administrata e Odës dhe listave që janë deklaruar për qëllime tatimore.

### ***Rreziqet***

Mospërputhja në mes të listës interne të pagave me ato që janë deklaruar në Administratën Tatimore të Kosovës mund të rezultojë në infomim jo të saktë dhe jokonsistent përsa i përket kostos së pagave.

### ***Rekomandimet***

Rekomandojmë që këto lista të harmonizohen dhe të ketë një gjurmueshmëri në mes të listave të pagave interne dhe atyre që deklarohen për qëllime tatimore.

### ***Përgjigja e menaxhmentit***

### **Statusi në auditimin e viteve 2021, 2020 dhe 2019**

E zgjidhur.



Raporti i auditorit të pavarur dhe pasqyrat financiare individuale  
Për fundin e vitit më 31 Dhjetor 2021, 2020 dhe 2019

**PËRMBAJTJA**

**FAQE**

RAPORTI I AUDITORIT

PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR

1

PASQYRA E TË ARDHURAVE

2

PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË EKUITET

3

PASQYRA E RRJEDHJES SË PARASË

4

SHËNIMET E PASQYRAVE FINACIARE

5



## RAPORTI I AUDITORIT TË PAVARUR

### Menaxhmentit të Odës së Farmacistëve të Kosovës

#### **Opinion**

Ne kemi audituar pasqyrat financiare shoqëruese të Odës së Farmacistëve të Kosovës, që përfshinë Pasqyrën e pozicionit financiar më 31 Dhjetor 2021, 2020 dhe 2019, Pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse, Pasqyrën e ndryshimeve në ekuitet dhe Pasqyrën e rrjedhës së parasë për vitin që ka përfunduar, si dhe një përmbledhje të politikave të kontabilitetit dhe shënimeve tjera shpjeguese.

Sipas mendimit tonë përveq qeshtjes së prezantuar më poshtë, pasqyrat financiare paraqesin drejtë, në të gjitha çështjet materiale pozicionin financiar të Odës së Farmacistëve të Kosovës më 31 Dhjetor 2021, 2020 dhe 2019, dhe performancën e saj financiare dhe rrjedhën e parasë për vitin që ka përfunduar në përputhshmëri me Ligjet aktuale në fuqi.

#### **Baza për Opinion**

##### **Ndryshimi në politikat kontabël**

Në vitin 2021 Oda e Farmacistëve të Kosovës ka ndryshuar politikat kontabël nga ajo në baza të keshit në parimin aktual të kontabilitetit. Si rrjedhojë shpenzimet dhe të hyrat janë njohur kur ato kanë ndodhur dhe jo kur paraja është paguar për to. Në bazë të standardit nderkombëtar të kontabilitetit 8 (IAS 8) ndryshimet në politikat kontabël, parashikimeve kontabël dhe gabimeve thelbësore, duhet të bëhet shpalosja e efektit të ndryshimeve kontabel edhe për periudhën paraprake. Për më tepër në bilancin e gjendjes të Odës së Farmacistëve të Kosovës është një vlerë e llogarive të arkëtueshme prej 23,840 euro si rezultat i këtyre ndryshimeve në politika. Gjatë procesit të auditimit ne nuk kemi mundur të sigurohemi për plotësinë e vlerës së llogarive të arkëtueshme me 31 Dhjetor 2021.

Ne kemi kryer auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar më tej në seksionin e raportit Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare. Ne jemi të pavarur nga Organizata në përputhje me Kodin e Etikës për Kontabilistët Profesionistë (Kodit IESBA), dhe kemi përmbushur përgjegjësitë tjera etike në përputhje me Kodin IESBA. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të ofruar bazat për opinionin tonë.

#### **Përgjegjësitë e Menaxhmentit dhe personave që janë të ngarkuar me qeverisjen e pasqyrave financiare**

Menaxhmenti është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të këtyre pasqyrave financiare në pajtueshmëri me ligjet aktuale në fuqi dhe për kontrollet e brendshëm të cilat menaxhmenti i vlerëson të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e pasqyrave financiare pa gabime materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, menaxhmenti është përgjegjës për vlerësimin e aftësinë së organizatës për vazhdueshmërinë në të ardhmen, duke shpalosur, sipas nevojës, çështjet lidhur me vazhdueshmërinë në të ardhmen dhe përdorimit të parimit të vazhdueshmërisë së kontabilitetit



përveç nëse menaxhmenti synon të likuideojë Organizatën apo të ndërpres operimin, apo nuk ka ndonjë alternativë tjetër të mundshme përveç se të bëjë atë.

Ata të cilët janë ngarkuar me qeverisje janë përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Organizatës.

### **Përgjegjësitë e Auditorit për auditimin e pasqyrave financiare**

Objektivat tona janë për të marrë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare si tërësi janë të lira nga gabimet materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe të nxjerrë një raport të auditorit që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është nivel i lartë i sigurisë, por nuk ka garanci që një auditim i kryer në përputhje me SNA-të gjithmonë do të zbulojë gabime materiale kur ato ekzistojnë. Gabimet mund të rrjedhin nga mashtrimet apo gabimet dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose në total, ato në mënyrë të arsyeshme mund të pritet të ndikojnë në vendimet ekonomike të përdoruesve të marra mbi bazën e këtyre pasqyrave financiare.

Si pjesë e një auditimi në përputhje me SNA, ne ushtrojmë gjykimin profesional dhe mbajmë skepticismin profesional gjatë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rrezikun e gabimeve materiale në pasqyrat financiare, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dizajnojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit të përshtatshme për këto rrezeqe, dhe marrim dëshmi të auditimit të mjaftueshme dhe e përshtatshme për të ofruar bazat për opinionin tonë. Rreziku i mos zbulimit të gabimeve materiale që rezulton nga mashtrimi është më i lartë se atij që rrjedh nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë marrëveshje të fshehta, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keqinterpretime, apo shkelje të kontrolleve të brendshme.
- I kuptojmë kontrollet e brendshme relevante për auditimin me qëllim të hartimit të procedurave të auditimit që janë të përshtatshme në rrethanat, por jo për qëllim të shprehjes së një opinionimi mbi efektivitetin e kontrolleve të brendshëm të Organizatës.
- I vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve kontabël dhe shpalosjet relevante të bëra nga menaxhmenti.
- Konkludojmë mbi përshtatshmërinë e përdorimit të parimit të vazhdueshmërisë së kontabilitetit nga menaxhmentit, duke u bazuar në dëshmitë e siguruar të auditimit, nëse një pasiguri materiale ekziston në lidhje me ngjarjet apo kushteve që mund të hedhë dyshime të konsiderueshme mbi aftësinë e organizatës për të vazhduar në vijimësi. Nëse arrijmë në përfundimin se një pasiguri material ekziston, ne jemi të detyruar të tërheqim vëmendjen në raportin tonë të auditimit për shpalosjet relevante në pasqyrat financiare apo, nëse shpalosjet e tilla janë të papërshtatshme, të modifikojmë opinionin tonë. Konkluzionet tona bazohen në evidencat e auditimit të marra deri në datën e raportit të auditimit. Megjithatë, ngjarjet ose kushtet në të ardhmen mund të shkaktojë që organizata të pushojë së vazhduari në vijimësi.

Ne komunikojmë me ata të ngarkuar me qeverisje lidhur me, në mesin e çështjeve tjera, qasjen e planifikuar dhe kohën e auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë çdo mangësi të rëndësishme në kontrollet e brendshme që kemi identifikuar gjatë auditimit.

Astrit Musa – Auditor Ligjor  
ACA – Audit & Consulting Associates  
Prishtinë, Kosovë  
02 Shtator, 2022



**Oda e Farmacistëve të Kosovës**  
**Pasqyra e Pozicionit Financiar**  
**Për fundin e vitit më 31 Dhjetor 2021, 2020 dhe 2019**

---

		Më 31 dhjetor 2021 (në EUR)	Më 31 dhjetor 2020 (në EUR)	Më 31 dhjetor 2019 (në EUR)
<b>ASETET</b>				
<b>Asetet qarkulluese</b>				
Paraja dhe gjendja në banka	3	40,543	72,948	69,293
Avanset e dhena		456	456	560
Llogaritë e arkëtueshme		23,840	310	-
<b>Totali i aseteve qarkulluese</b>		<u>64,840</u>	<u>73,714</u>	<u>69,853</u>
<b>TOTALI I ASETEVE</b>		<u><b>64,840</b></u>	<u><b>73,714</b></u>	<u><b>69,853</b></u>
<b>DETYRIMET DHE EKUITETI</b>				
<b>Detyrimet rrjedhëse</b>				
Llogaritë e pagueshme	4	6,508	8,488	8,068
<b>Totali i detyrimeve rrjedhëse</b>		<u>6,508</u>	<u>8,488</u>	<u>8,068</u>
<b>Ekuiteti</b>				
Saldoja e bartur		65,226	61,785	50,815
Net (deficiti)/suficiti i vitit		(6,894)	3,441	10,970
<b>Totali i ekuitetit</b>		<u>58,332</u>	<u>65,226</u>	<u>61,785</u>
<b>TOTALI I DETYRIMEVE DHE EKUITETIT</b>		<u><b>64,840</b></u>	<u><b>73,714</b></u>	<u><b>69,853</b></u>

Pasqyrat financiare janë nënshkruar në 02 Shtator 2022 nga:

**Arianit Jakupi**

---

**Kryetar**

Shënimet e bashkangjitura nga 1 deri në 9 janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare

**Oda e Farmacistëve të Kosovës**  
**Pasqyra e të ardhurave**  
**Për fundin e vitit më 31 Dhjetor 2021, 2020 dhe 2019**

---

	Shënimi	Fundi i vitit 31 Dhjetor 2021 (në EUR)	Fundi i vitit 31 Dhjetor 2020 (në EUR)	Fundi i vitit 31 Dhjetor 2019 (në EUR)
<b>Të hyrat</b>				
Të hyrat	5	138,174	101,627	189,055
<b>Totali i të hyrave</b>		<b>138,174</b>	<b>101,627</b>	<b>189,055</b>
<b>Shpenzimet</b>				
Shpenzimet e pagave	6	108,047	78,612	79,523
Shpenzimet administrative	7	16,339	10,886	59,496
Shpenzimet tjera	8	20,682	8,688	37,717
<b>Totali i shpenzimeve</b>		<b>145,068</b>	<b>98,186</b>	<b>176,735</b>
Shpenzimet e ndeshkimeve per tatime dhe kontribute		-	-	1,349
<b>Pjesa e mbetur</b>		<b>(6,894)</b>	<b>3,441</b>	<b>10,970</b>

Shënimet e bashkangjitura nga 1 deri në 9 janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare

**Oda e Farmacistëve të Kosovës**  
**Shënimet e rrjedhës së parasë**  
**Për fundin e vitit më 31 Dhjetor 2021, 2020 dhe 2019**

	<b>Fundi i vitit 31 Dhjetor 2021 (në EUR)</b>	<b>Fundi i vitit 31 Dhjetor 2020 (në EUR)</b>	<b>Fundi i vitit 31 Dhjetor 2019 (në EUR)</b>
<b>Rrjedha e parasë nga aktivitetet operuese</b>			
<b>Mbetja gjatë operimit</b>	(6,894)	3,441	10,970
Rregulluar për:			
Ndryshimet në të arkëtueshmet	(23,530)	(310)	-
Ndryshimet në të pagueshme	(1,981)	420	(1,583)
Ndryshimet në pasuritë tjera	-	104	(560)
<b>Paratë e gjeneruara nga operimet</b>	<b>(32,404)</b>	<b>3,655</b>	<b>8,827</b>
<b>Rrjedha e parasë nga aktivitetet investuese</b>	-	-	-
Blerja e pronës dhe e paisjeve	-	-	-
Zvogelim i kapitalit	-	-	-
<b>Paraja neto e përdorur në investime</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>-</b>
<b>Ndryshimet neto në para dhe ekuivalent</b>	<b>(32,404)</b>	<b>3,655</b>	<b>8,827</b>
Paraja dhe ekuivalentet e parasë më 1 Janar	72,948	69,293	60,466
<b>Paraja dhe ekuivalentet më 31 Dhjetor</b>	<b>40,544</b>	<b>72,948</b>	<b>69,293</b>

Shënimet e bashkangjitura nga 1 deri në 9 janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare

**Oda e Farmacistëve të Kosovës**  
**Shënimet e Pasqyrave Financiare**  
**Për fundin e vitit më 31 Dhjetor 2021, 2020 dhe 2019**

---

**1. HYRJE**

Oda e Farmacistëve të Kosovës është organizatë e pavarur e cila mbron dhe prezanton interesat profesionale të anëtarëve të saj, siguron standardet e larta të kodit të etikës dhe deontologjisë mjekësore, promovon dhe mbronë veprimtarinë e profesionistëve shëndetësorë në institucionet shëndetësore publike dhe private, siguron edukimin e vazhdueshëm profesional me qëllim të ofrimit sa më cilësor të shërbimeve shëndetësore dhe shërbimeve tjera që kanë të bëjnë me kujdesin shëndetësor.

**Misioni dhe Visioni**

Misioni dhe visioni i Odës së Farmacistëve të Kosovës është profesionalizmi dhe siguria e përdorimit të barnave

## **2. BAZA E PËRGATITJES DHE POLITIKAT E RËNDËSISHME KONTABËL**

### **2.1 Baza e përgatitjes**

Pasqyrat financiare për Organizatën janë përgatitur në bazë të kontabilitetit në bazë të keshit për të hyrat dhe shpenzimet. Bazat e matjes janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në politikat e kontabilitetit të paraqitura më poshtë.

### **2.2 Valuta e përdorur**

Valuta funksionale e Organizatës është valuta e Bashkimit Evropian Euro ("EUR"). Pasqyrat financiare janë prezantuar në euro.

### **2.3 Të arkëtueshmet tregtare**

Të arkëtueshmet tregtare fillimisht njihen me vlerën e drejtë dhe më pas mbarten me kosto minus provizionet, nëse ka. Një provizion njihet kur ka dëshmi objektive që Organizata nuk do të jetë në gjendje të mbledhë të gjitha shumat e duhura sipas kushteve fillestare të të arkëtueshmeve. Shembuj të dëshmimeve objektive mund të jenë vështirësitë e mëdha financiare të klientit, probabiliteti i madh që klienti të falimentojë si dhe vonesat e vazhdueshme në pagesa.

### **2.4 Të arkëtueshmet tjera**

Në llogaritë e të arkëtueshmeve tjera përfshihet parapagimet dhe pasuritë e tjera qarkulluese. Parapagimet mbahen me kosto minus provizioni nëse ka. Një parapagim klasifikohet si afatgjatë kur mallrat ose shërbimet që lidhen me parapagimin pritet të merren pas një viti.

### **2.5 Paraja dhe ekuivalentet e parasë**

Për qëllime të pasqyrës së rrjedhës së parasë, paraja dhe ekuivalentët e parasë janë konsideruar të jenë paraja e gatshme si dhe ajo në llogari rrjedhëse, si dhe paraja me maturitet jo më shumë se tre muaj.

### **2.6 Të pagueshmet tregtare**

Shumat e pagueshme janë matur në kosto që është vlera e drejtë e shumës për t'u paguar në të ardhmen për mallërat dhe shërbimet që janë marrë.

**Oda e Farmacistëve të Kosovës**  
**Shënimet e Pasqyrave Financiare**  
**Për fundin e vitit më 31 Dhjetor 2021, 2020 dhe 2019**

---

## **2.7 Tatimet**

Organizata u themelua si një organizatë joqeveritare, për këtë arsye ka përgjegjësi dhe vepron si një OJQ sipas ligjeve në fuqi të Kosovës.

## **2.8 Njohja e të hyrave**

Të hyrat gjatë viteve 2019 dhe 2020 janë njohur si të hyra në bazë të keshit në periudhën kur janë paguar, ndërsa në vitin 2021 organizata ka kaluar në baza akruale duke i njohur të hyrat në momentin që ato kanë ndodhur. Në fund të vitit sasia e tepërt e të ardhurave krahas shpenzimeve trajtohen si bilanc i bartur në periudhën e ardhshme.

## **2.9 Shpenzimet**

Shpenzimet e ndodhura janë njohur në periudhën përkatëse në baza të keshit.

## **2.10 Përfitimet e të punësuarve**

Organizata, në rrjedhën normale të biznesit, bën pagesa në buxhetin e shtetit për llogari të puntorëve. Puntorët e Organizatës janë anëtarë të planit shtetëror të pensioneve. Të gjitha kontributet e tilla në skemat e pensioneve të detyrueshme qeveritare shpenzohen kur ato ndodhin. Organizata nuk operon asnjë skemë tjetër pensioni ose plan përfitimesh pas daljes në pension dhe, rrjedhimisht, nuk ka asnjë detyrim në lidhje me pensionet.

Për më tepër, Organizata nuk ka detyrime materiale për të siguruar përfitime të mëtejshme për puntorët paraprak dhe aktual.

**Oda e Farmacistëve të Kosovës**  
**Shënimet e Pasqyrave Financiare**  
**Për fundin e vitit më 31 Dhjetor 2021, 2020 dhe 2019**

**3. PARAJA DHE EKUIVALENTET E PARASË**

	<b>Më 31 dhjetor 2021 (në EUR)</b>	<b>Më 31 dhjetor 2020 (në EUR)</b>	<b>Më 31 dhjetor 2019 (në EUR)</b>
Paraja në bankë-NLB Bank - Nenllogaria	10	5,705	57,726
Paraja në bankë-NLB Bank	40,534	67,242	11,567
<b>Totali parasë dhe gjendjes në bankë</b>	<b>40,543</b>	<b>72,948</b>	<b>69,293</b>

**4. TË PAGUESHMET**

	<b>Më 31 dhjetor 2021 (në EUR)</b>	<b>Më 31 dhjetor 2020 (në EUR)</b>	<b>Më 31 dhjetor 2019 (në EUR)</b>
Llogarite e pagueshme - Furnitor	4,495	353	4,123
Detyrimi ndaj pagave	461	6,141	1,741
Detyrimi ndaj tatimit ne paga	728	937	969
Detyrimi ndaj kontributeve punetori	412	528	617
Detyrimi ndaj Kontributeve punedhenesi	412	528	617
<b>Totali i llogarive të pagueshme</b>	<b>6,508</b>	<b>8,488</b>	<b>8,068</b>

**5. TË HYRAT**

	<b>Më 31 dhjetor 2021 (në EUR)</b>	<b>Më 31 dhjetor 2020 (në EUR)</b>	<b>Më 31 dhjetor 2019 (në EUR)</b>
Të hyrat nga Antarësimet	88,395	75,276	42,820
Të hyrat nga pjesëmarrja në konferencë	20,671	1,650	75,925
Të hyrat nga Licencimet	8,810	10,170	9,470
Të hyrat nga Rilicencimet	7,353	5,201	7,250
Të hyrat nga sponsorizimet	7,200	4,530	52,495
Të hyrat nga Akreditimi	2,400	1,600	-
Të hyrat nga mbajtja e provimit te rilicensimit	1,750	2,800	-
Të hyrat nga dhenja e Faksimilit	305	180	360
Të hyrat nga pagesa e vertetimit te Kodit Etik	90	10	35
Të hyrat tjera	1,200	210	700
<b>Totali i të hyrave</b>	<b>138,174</b>	<b>101,627</b>	<b>189,055</b>



**Oda e Farmacistëve të Kosovës**  
**Shënimet e Pasqyrave Financiare**  
**Për fundin e vitit më 31 Dhjetor 2021, 2020 dhe 2019**

---

**6. SHPENZIMET E PAGAVE**

	<b>Më 31 dhjetor 2021 (në EUR)</b>	<b>Më 31 dhjetor 2020 (në EUR)</b>	<b>Më 31 dhjetor 2019 (në EUR)</b>
Pagat bruto	102,918	74,865	75,736
Kontributet pensionale	5,129	3,746	3,787
<b>Totali i pagave dhe përfitimeve</b>	<b>108,047</b>	<b>78,612</b>	<b>79,523</b>

**7. SHPENZIMET ADMINISTRATIVE**

	<b>Më 31 dhjetor 2021 (në EUR)</b>	<b>Më 31 dhjetor 2020 (në EUR)</b>	<b>Më 31 dhjetor 2019 (në EUR)</b>
Shpenzimet e printimit	10,205	-	-
Materialet per zyre	4,201	6,258	6,003
Shpenzimet e telefonit	635	106	672
Shpenzimet bankare	624	483	642
Shpenzime për derivate	357	550	1,320
Shpenzimet per Internet	217	230	120
Shpenzime për organizimin e konferencës	100	3,259	50,740
<b>Totali i shpenzimeve administrative</b>	<b>16,339</b>	<b>10,886</b>	<b>59,496</b>

**Oda e Farmacistëve të Kosovës**  
**Shënimet e Pasqyrave Financiare**  
**Për fundin e vitit më 31 Dhjetor 2021, 2020 dhe 2019**

---

**8. SHPENZIMET TJERA**

	<b>Më 31 dhjetor 2021 (në EUR)</b>	<b>Më 31 dhjetor 2020 (në EUR)</b>	<b>Më 31 dhjetor 2019 (në EUR)</b>
Shpenzime për anëtarësime	6,470	2,493	-
Shpenzimet për web	4,510	1,460	5,230
Shpenzimet për obelisk	3,748	-	-
Shpenzimet e akomodimit	1,954	291	3,725
Shpenzimet e ushqimit	1,534	-	-
Shpenzimet e udhëtimit	1,414	1,492	15,143
Shpenzimet e reprezentacionit	504	152	2,922
Shpenzimet e perkthimit	350	-	1,450
Shpenzimet e Ujit	199	77	-
Shpenzimet e reklamave	-	823	1,882
Pergaditja e projektit te barnatores	-	1,900	-
Shpenzimet e Solidaritetit	-	-	1,000
Shpenzimet e Kontabilitetit	-	-	2,765
Shpenzimet Juridike dhe te Auditimit	-	-	3,600
<b>Totali i shpenzimeve tjera</b>	<b>20,682</b>	<b>8,688</b>	<b>37,717</b>

**9. NGJARJET E MËPASME**

Në kohën e përgatitjes së raportit të auditimit, organizata ka vazhduar operimet dhe ka qenë në gjendje t'i përmbushë obligimet, për këtë arsye raporti është përgatitë duke përdorur bazën e vijimësisë.